


# Kadare

ca pika shiu ranë mbi qelq



dyzet poezi të zgjedhura



Onufri

1

Parafytyroni Ismail Kadarenë në mbarim të viteve '50 dhe vargun, për mua, çelës në universin e tij poetik *Un 'tek udha kam dalë dhe rri...* (Fusha shtrihet e errët, 1957). Lexuesi i vëmendshëm këtë perceptim nuk do ta kapë si daldisje të poetit pas të dashurës, por si revoltë e heshtur, thënë përmes një lirizmi të zymtë e mjaft sugestiv, që vijëzon dhe atmosferën e shoqërisë shqiptare, e cila gjysmëshekulli përpërlej e dëgjonte propagandën e ditës si refren monoton: *te ne gjithçka është e bardhë...*

Fusha e errët do e përcjellë si hije në ecejake poetin dhe do të bëhet shqetësuese mbasi fundi nuk i dukej. *Me jakën e ngritur èndërrroja në shi*, thotë ai në *Poemë vjeshte*. Dhe, poezi pas poezie disi plotësohet imazhi. Pra, pakgjë shihej më tutje dhe atë që ta kapë syri ishte vetëm një kreaturë frike, që kishte depërtuar dhe në èndrrën e njeriut të kyçur në kohë bunkerizmi. Kadare, i vetëdijshëm për kredon krijuese, nuk mund të pranonte miopsinë ndaj së shëmtuarës, që rrënon dinjitetin njerëzor dhe autoritetin e Shqipërisë para botës, se një vend pa krenarinë e moralin i ngjan guaskës boshe me të cilin luajnë valët e mistershme. Ishte i bindur se ato tërmete e zjarre të brendshme duhet të nxirreshin jashtë. Por, hulumtohej ajo fuqi magjike e fillonte seleksionimi i elementeve shprehëse. E, të vetmen armë poeti ka fjalën. Nga ajo kërkon edhe të pamundshmen për të bërë mrekullira. Të dëshmohet se brenda bunkerizmit të zymtë frymonte edhe diçka e shëndetshme: njerëzorja, e lashta e dënuar, e bukur...

Ndokush artikulimin e Kadaresë do ta shikojë me sy të keq dhe do ta kapë si provokim, por mu te ky dyshim hetohet kurajoja intelektuale, se me pakënaqësinë qiste krye rebelimi i tij, që edhe në romanet e tij do ta ndeshim si sarkazmë, alegori, si një ortek që vë përpara të keqen. Vështrohet, hulumtohet, perceptohet e thuhet më sublimja në universin e tij; ngritën ide që të dilet nga labirinti shqiptar dhe përmes tyre komunikon me lexuesin-interpretin, kohët i shndërron në nyje aty në fushën e errët. E djeshmja fillon te e sotmja dhe e tanishmja diku thellë në kohëra. Kështu, në tekstin e tij, për mrekulli inkuadron bërnat nga lashtësia shqiptare, po dhe nga mitologja



Onufri

## NGA I NJËJTI AUTOR

- Dialog me Alain Bosquet*, 1996, 1996, 1999, 2003  
*Spiritus*, roman, 1996, 2000, 2003  
*Kushëriri i engjëeve*, ese, 1997, 2003  
*Tri këngë zie për Kosovën*, triptik, 1998, 1999, 2003  
*Kombi shqiptar në prag të mijëvjeçarit të tretë*, ese, 1998  
*Pallati i Ëndrrave*, roman, 1999, 2003  
*Ikja e shtërgut*, tregim, 1999, 2003  
*Qorrfermani*, roman, 1999  
*Vjedhja e gjumit mbretërор*, tregime, 1999  
*Ra ky mort e u pamë*, ditar për Kosovën, artikuj, letra, 1999, 2000  
*Kohë barbare (Nga Shqipëria në Kosovë)*, biseda, 2000  
*Kronikë në gur*, roman, 2000  
*Breznitë e Hankonatëve*, 2000  
*Bisedë përmes hekurash*, 2000  
*Lulet e ftohta të marsit*, roman, 2000, 2003  
*Unaza në kthetra*, biseda, artikuj, intervista, ese, 2001, 2003  
*Eskili, ky humbës i madh*, 2001, 2003  
*Qyteti pa reklama*, roman, 2001  
*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, roman, 2001  
*Përballë pasqyrës së një gruaje*, tre romane, 2001, 2003  
*Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut*, roman, 2002, 2003  
*Stinë e mërzitshme në Olymp*, dramë, 2002  
*Autobiografia e popullit në vargje*, 2002  
*Hija*, roman 2003  
*Këshijella*, roman, 2003  
*Prilli i thyer*, roman, 2003  
*Viti i mbrapshtë*, roman, 2003

..

## MBI AUTORIN

- 1) *Alfred Uçi*, Grotesku kadarean
- 2) *Bashkim Kuçuku*, Kadare në gjuhët e botës
- 3) *Tefik Çaushi*, Kadareja përmes pasqyrave

854-1

K 14

ismail kadare

ca pikä shiu ranë mbi qelq

dyzet poezi të zgjedhura



Onufri

*Përgatiti për botim:  
Bujar Hudhri*

© Onufri, 2003

*Të gjitha të drejtat e botimit, në gjuhën shqipe,  
brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë,  
i takojnë Shtëpisë Botuese Onufri*

ISBN 99927-53-52-8

Shtëpia Botuese Onufri, Rr. "S. Pasha", Tiranë  
Tel&Fax 00355 4 220 017 <http://www.Onufri.com>  
E-mail:onufri@abissnet.com.al

## REVOLTË E HESHTUR PËRMES LIRIZMIT

### 1.

Parafytyroni Ismail Kadarenë në mbarim të viteve '50 dhe vargun, për mua, çelës në universin e tij poetik *Un' tek udha kam dalë dhe rri...* (Fusha shtrihet e errët, 1957). Lexuesi i vëmendshëm këtë perceptim nuk do ta kapë si dalldisje të poetit pas të dashurës, por si revoltë e heshtur, thënë përmes një lirizmi të zymtë e mjaft sugjestiv, që vijëzon dhe atmosferën e shoqërisë shqiptare, e cila gjysmëshekulli përpërlej e dëgjonte propagandën e ditës si refren monoton: *te ne gjithçka është e bardhë...*

Fusha e errët do e përcjellë si hije në ecejake poetin dhe do të bëhet shqetësuese mbasi fundi nuk i dukej. *Me jakën e ngritur èndërroja në shi*, thotë ai në *Poemë vjeshte*. Dhe, poezi pas poezie disi plotësohet imazhi. Pra, pakgjë shihej më tutje dhe atë që ta kapë syri ishte vetëm një kreaturë frike, që kishte depërtuar dhe në èndrrën e njeriut të kyçur në kohë bunkerizmi. Kadare, i vetëdijshëm për kredon krijuese, nuk mund të pranonte miopsinë ndaj së shëmtuarës, që rrënon dinjitetin njerëzor dhe autoritetin e Shqipërisë para botës, se një vend pa krenarinë e moralin i ngjan guaskës boshe me të

cilin luajnë valët e mistershme. Ishte i bindur se ato tërmete e zjarre të brendshme duhet të nxirreshin jashtë. Por, hulumtohej ajo fuqi magjike e fillonte seleksionimi i elementeve shprehëse. E, të vetmen armë poeti ka fjalën. Nga ajo kërkon edhe të pamundshmen për të bërë mrekullira. Të dëshmohet se brenda bunkerizmit të zyntë frymonte edhe diçka e shëndetshme: njerëzorja, e lashta e dënuar, e bukura...

Ndokush artikulimin e Kadaresë do ta shikojë me sy të keq dhe do ta kapë si provokim, por mu te ky dyshim hetohet kurajoja intelektuale, se me pakënaqësinë qiste krye rebelimi i tij, që edhe në romanet e tij do ta ndeshim si sarkazmë, alegori, si një ortek që vë përpara të keqen. Vështrohet, hulumtohet, percptohet e thuhet më sublimja në universin e tij; ngritën ide që të dilet nga labirinti shqiptar dhe përmes tyre komunikon me lexuesin-interpretin, kohët i shndërron në nyje aty në fushën e errët. E djeshmjë fillon te e sotmja dhe e tanishmjë diku thellë në kohëra. Kështu, në tekstin e tij, për mrekulli inkuadron bëmat nga lashtësia shqiptare, po dhe nga mitologjia helene; bredh në botën shekspiriane dhe na përkujton gjëra makabre. *Mjaft më helmin në vesh*, dëgjohet poeti, tek ia bën me gisht diktaturës, e cila u mbyll turpshëm, duke shembur veten më shumë se gëlltitësit përreth. Po e ardhmja? Maalaut thotë: “E ardhmja nuk është shkruar asgjékund, e ardhmja është ashtu si do ta bëjmë ne”, pra duhet dhënë shenjë se je gjallë; se duhet vepruar kundër së keqes në fushën e errët, ku “*gjithçka është e varfér, e mjerueshme, e frikshme*” (Dirck Schümer).

Disa poezi edhe të kësaj përzgjedhjeje autoriale të Kadaresë kanë përfundim të papritur, paralajmërohen ndarje, përplasje, shantazhe; na shfaqet *malli bojë hi ...adresat humben* (poezia Llora) një artikulim imagjinativ i shkallës

së lartë. Po kjo duhet shikuar nga një aspekt tjetër, si aftësi e poetit, që shqetësimi ve personale u jep dimensione kombëtare. Bëhen çështje të theksuara. E, kjo është veti e krijuesve të mëdhenj. Fatin e individit nuk mund ta shohin ndaras fatit të popullit, siç nuk mund ta pranojnë triumfin e kombëtares si fitore fisi, por të kombit. Dhe tek lexon një lirikë me subjekt dashurie, bindesh më vonë se ke hapur një fletë tronditëse nga historia njerëzore, ashtu depërtón në çështje mëse qeniesore të ekzistencës së një populli. Kadarenë e tmerron kufizimi i lirisë. (Ri)lexojeni poezinë *Mall* dhe ndaluni te thënia e Heraklitit: *Të zgjuarit janë bashkë me botën/ Kurse të fjeturit janë veç*. Thënie kjo e njohur, e që Kadare ia gjen vendin diku ne strofën e tretë të poezisë së lartpërmendor. Nuk iu zgjon kjo asociacione me mbylljen tonë një gjysmëshekulli, se vërtet tepër gjatë ishim në gjumë, as veten nuk e njihnim se na mungonte kurajoja? Shikimi ynë thyhej aty te muri. Është e besueshme kur poeti u drejtohet brezave të ardhshëm: *se shumë fjalë do t'i ketë zhdukurjeta...* (Epilogu i brezave që vijnë), apo shfajësimi ndaj një qytetërimi që deri dje e kishim sharë: *Ne pjellë e saj, robër të saj, mbretër të saj të rremë...* (Krishtlindjet në New York, 1997). E, ky udhëtim imaginativ i Kadaresë me harkun kohor prej katërdhjetë vjetësh (1957-1997), me gjithsej 40 poezi, nxit të bësh pyetje: dolëm nga ajo fushë e errët apo mbi “varrezë bubullimash” do të endemi si të përhëntë?

## 2.

Kompleti i veprave të Kadaresë doli në botim të “Rilindjes” (Prishtinë, 1980), më herët seç duhej të shihte dritën në vendin amë. Libri i dhjetë ishte përzgjedhja e

poezive dhe më ishte besuar mua. Titullohet *Buzëqeshje mbi botë*. Ishte konceptuar mes dy poezive *Vallja shqiptare* dhe *Kënga e ushtarëve të vjetër*. Me këtë të dytën, pse po e mbyllja librin? Shkak ishte vargu: *Nga lufta vijmë në luftëra shkojmë*. Parandjenjë e çuditshme me atë që ndodhi në Kosovë në vitin biblik (1999) kur barbaria serbe dogji edhe gurin e shtëpisë. Ndërsa jashtë kisha lënë një pjesë dërmuese të poezive dhe poemat që nuk i bërin nder. Koncepti im ishte diçka tjetër. Besoja se krijuesi krijuesit duhet t'i zgjedhë vlerat e konfirmuara. Kështu mbron edhe letërsinë kombëtare. Frika e Kadaresë ishte dhe frika ime, por unë theksoj se vlera dhe guximi nuk mund të rrinë ndaras. Libri personal i tij për mua ishte një lehtësim se kisha vepruar drejt. Në përgjedhjen e vet Kadare shkoi më larg. Është treguar tepër rigoroz. Kjo ndodhi me siguri për hir të poeziës, të këtij arti elit. Lasgushi nuk ishte i vetmi që e bezdiste edhe një fjalë, edhe një figurë. Gjatë përpilimit të *Buzëqeshjes mbi botë* më kishte trandur një piru, i cili vërvitej atje lart mbi botë. Pas Kosovës, Çamërisë, Mbishkodrës e trojeve të tjera kush e kishte radhën? Bën Shqipëria të jetë më xhuxhe?

### 3.

Në vitet '70 nacionalizmi serb ishte egërsuar. Nuk kishte poetë që për subjekt nuk e kishin mitin e Kosovës. As nuk mund të konsideroheshin kombëtarë ata krijues që realitetin e shikonin ndryshe. *Ujku i çalë* ishte lajtmotiv nga poetët më të rinj e deri te Vasko Popa (Vasil Popeski, ishte rumun). Shkrimit kishte zënë t'i vijë erë temjani dhe poezia të pagëzohet *arttemjan*. Nga libri i dhjetë i kompletit të Kadaresë kisha nxjerrë poezinë *Mundja e ballkanasve nga turqit në Fushën e Kosovës më 1389*. Kjo u botua pastaj në

një gazetë letrare serbe. Lexuesit e kritika e atjeshme e kishin pranuar si polemikë të mençur, ndërsa nacionalistët si dush ndaj nacionalizmit serb. Një poezi e Kadaresë luhati mitin e rremë mbi Kosovën, megjithëse edhe tani e përdorin si tapi ndaj trojeve tonë të aneksuara. Guximi intelektual i shkrimtarit tonë bën të quhet dhe fenomen Kadare.

Libri *Ca pika shiu ranë mbi qelq*, lexohet në shumës, fat i një populli të thënë përmes shqetësimeve e kurajos së individit. Do më vinte keq po qe se ky libër mbetet i fundit i emblemës sonë kombëtare, siç e quajti bashkëkohësi i tij, Dritëro Agolli.

Ali Podrimja

*Ulpianë, 15.10.2003*

## FUSHA SHTRIHET E ERRËT

Fusha shtrihet e errët tutje.  
Drurët nxijnë tek-tuk si hajdutë.

Diku larg vetëtin, bie shi.  
Un' tek udha kam dalë edhe mri.

Drurët nxijnë tek-tuk si hajdutë,  
Sikur ruajn' mos vish ti që tutje.

1957

## MBRËMJA E FUNDIT NË MOSKË

Në xhep, biletë e aeroplanit.

Nesër iki.

Kjo është përgjithnjë, e dashur.

Te dera e ashensorit, e hekurt

Të përcolla për të fundit herë: kur

Do të shihemi më vallë?

U puthëm.

Buzët si të metalta.

Pra, lamtumirë!

Ashensori lart si drejt qiejve të ngriti në errësirë.

*Moskë, 1960*

## PIZHAMET DHE AEROPORTET

Mizat ulen me zukatje  
Mbi vijat e pizhameve  
Dhe avionët me uturimë  
Mbi pistat e aeroporteve.  
Mos më lër kurrë, o moj botë e madhe,  
Mos m'i mbyll kurrë portat!

Ka dashuri të vogla  
Dashuri të para, dashuri nr. 1,  
Dashuriza,  
Që zukatin në kujtesë posa miza,  
Që bëjnë kakao,  
Që lajnë kanotiera;  
Ka dhe dashuri të mëdha, të lira si era,  
Mbetur tutje-tëhu nëpër botë anembanë  
Që s'na dijnë ku jemi,  
Që s'i dijmë ku janë.

Dashuri e vogël kërkon të kthej fotografitë;  
Dashurive të mëdha u merr erë flokët ndanë binarëve,  
Ngulçimet e tyre u ngajnjë sirenave,  
Sirenave të hapësirta të ndarjeve.

Mos më lër kurrë, o moj botë e madhe!  
Po të mbylla derën.  
Thyeje, bëje fërtete!  
Pas dritares sime  
Të varen në tela  
E të tunden nga era  
Kanotieret e reve.

Mbi vijat e pizhameve të mia avionët të ulen me poterë...

1961

## IKJA E MOJSI GOLEMIT

1

Kjo rruga përdridhet  
Si gjarpër i zi.  
Për ku po vrapon,  
Gjeneral Mojsi?  
Pelerinën era  
Ta ngre me tallaz.  
Gjeneral Mojsi,  
Pluhur shumë lë pas.

2

Kali përpin udhët,  
Muzgu bie ngadal'.  
Pse të dridhet freri  
Dorës, gjeneral?  
Leshrat gjithë pluhur  
Të godasin sytë.  
Mbi boshllék të syve  
Balli i ftohtë i yt.



3

Mbrëmja hesht mbi udhët.  
Larg zjarre çobenjsh.  
Gjeneral Mojsi,  
Përse shpatën zhvesh ?  
Rruga është e shkretë,  
Trokut natën mbush.  
Veç ndërgjegjes sate  
Prapa s'të ndjek kush.

4

Ik e ik përpara.  
Mbrëmja nxin dhe nxin.  
I ndërgjegjes troku  
Prapa oshëtin.  
Kalin tënd për freri  
Ajo seç ta ze.  
Ti në vrap e sipër  
Shpatën vrulltas ngre.

5

Mojsi, ndërgjegjes,  
Vallë si i re?  
Ajo erret, bie  
Mbytur gjak përdhe.  
Në terr thundër e kalit  
Xixa shkrepëtit.

Ndan' udhës së madhe  
Ndërgjegjja jep shpirt.

6

Kali i egërsuar  
S'lë pas tym, po re.  
Qetësi pas teje.  
Ajo mbet atje.  
Mbi gropat e udhës  
Si mbi plagë trokon.  
Rrafshira të zymta.  
Muzg i vjeshtës vonë.

7

Ik, e ik, e zezë  
Ruga-shkretëti.  
O, sa ankth e tmerr  
Ka kjo qetësi.  
Trok i tradhtisë  
Natën mbyt e mbush.  
Kokën pas ç'e kthen,  
Prapa s'të ndjek kush.

8

Rrotull veç një rah  
Shtrihet nënë re.

Toka është veç baltë,  
Por jo më atdhe.  
Toka si vejushë  
Hoqi çdo stoli.  
Vdiq atdheu, mbet balta,  
Nën trokun e zi.

9

Qindra vjetë shkuan,  
Ti lëviz si ankth.  
Dimëron në qiej,  
Por dheu s'të qas.  
Në kaldrëme shekujsh  
Trokut i zi,  
Mojsi i Golemëve,  
Gjeneral Moj-Zi.

1961

20

## KËNGA E MILLONAIT

Këngë e mokrave  
Sonte fund nuk ka.  
Ç'heshtje pragut ti,  
O mor millona.  
I mendimeve  
Vargu nuk t'u sos.  
Cigare « Diamanti »  
Ç'po tymos, tymos.

Herë zbardh mielli,  
Herë mërzia nxin,  
Gojëhapurin thes  
Mbushin me mundim.  
Kokën grushteve,  
Të të bjerë, ç'e le.  
Po përse, përse,  
Millona, ti ç'ke?

Derdhet mielli,  
Miell i bardhë, oh,  
Martohet në fshat  
Vajza që ti do.

Do bëjnë me të  
Pite, bakllava.  
Ndaj te pragu ti  
Heshte, millona.

Këngë e mokrave  
Sonte mbrëmjen mbush.  
Ç’të kujtohet vallë  
Me kokën në grusht.  
Matanë SMT-së  
Muzgu kaltërosh,  
Kur të puthte dhe  
« Të dua » të thosh.

E trokashkave  
Kënga natën vret.  
Nesër dasmë ka  
Në lokalitet.  
Do të ngrejë dolli  
Një shok i byrosë.  
Vetëm ti atje,  
Millona, s’do shkosh.

Në mes vajzave  
S’do të hidhesh ti,  
S’do t’i vish ndër mend  
Askujt në gosti.  
Mes muzikave  
S’do dëgjojë kush,

Si mulliri yt  
Sonte natën mbush.

Mes trokashkave  
Të duket sikur  
I gërmnetës vaj  
Mu në gjoks t'u ngul.  
Do të hedhë atje  
Dhëndri një shaka,  
Qeshje e vjehrrës, ah,  
Thikë: « ha-ha-ha ».

Vallen mblesi plak  
Do ta heqë pastaj.  
Shkel opingë e tij  
Dashurinë e saj.  
Thërresin krushqit « Brom! »  
Hidhen krushqit « Hop! »  
Këpucët mbi gjoks  
Sikur hapin gropë.

Vetëm nuses ti,  
Djalo do t'i dhembsh.  
Do t'i mblidhet shpesh  
Mu në gjoks një lëmsh.  
Dorë e bardhë e saj  
Do hollojë byrek.  
Zemra jote e madhe  
Shtrirë n'ato petë.

Por tek sofra ajo  
S'do dyshojë aspak,  
Mos në miell ti  
Ke hedhur farmak.  
Ta njeh zemrën ty.  
O mor millona,  
Ndaj nga helmi yt  
Ajo frikë s'ka.

Ç'po përtypin grurë  
Nofullat me gur.  
Një miell si ky  
Ti nuk blove kurrë.  
Më lehtë zemrën sot  
Kishe bluar ti.  
Qepallat si plumb  
Të rëndoijnë tani.

Herë nxin mielli,  
Herë mërzia zbardh.  
Thesi ja u mbush,  
Koka ty t'u var.  
Tani mielli i dasmës  
Mbi supe të ra,  
Të mbuloi krejt  
Porsi mjegulla...

Djalo, millona.

1961

## LLORA

I

Llora,  
Prapë m'u kujtove, Llora.  
Dashurinë tonë të shkuar  
Prapë ripërtyp  
Si demi që ripërtyp barin e livadheve të largët  
Natën  
Në grazhdin e rrëthuar nga bora.

Po ripërtyp  
Atë asfalt e zhavorr të zi kërcitës,  
Boritë dhe katroret mizëri të takutive,  
Tabelat e kafeneve plot dritë,  
Afishe, stacione metrosh  
Ku me ty brodha.

Nofullat e zemrës  
Më dhembin,  
Llora.

## II

Tani shiu godet me shkelma qelqeve.  
Atje qielli i zi si negativi i një shkretëtire.  
Llora,  
Më ka marrë malli  
Mall bojë hiri.  
Tani nata si një mbulesë vigane  
Qëndisur me drita anëve,  
Karfosur me paralele dhe meridianë  
Nga lindja në perëndim  
Na mbulon e shqetësuar.  
Ne shtrihemi nën të,  
Si në ethe zbulohemi  
Të ndarë,  
Të largët, .  
Të vëtmuar.

Pati net,  
I qullur nga stuhia jote,  
Heshtja pranë teje dhe pasionit të marrë,  
Mbërthyer mbi krahët dhe këmbët e tua  
Si mbi një kryq të madh  
Të bardhë.

Në fillim e mora kaq lehtë.  
Madje s'thosha as fjalën « dashuri ».  
S'e dija se dhjetë vjet më i ri se Krishti  
Do të kryqëzoheshë mbi ty.

### III

Ja

Vetëtimat e verdha në qiej  
Adresën tënde shkarravisin.

Sikur këto re  
Të përhimta,  
Të ngarkuara  
Të t'i dërgoja si letra, Larisa.

Letra...

Nga gjithë letrat që shkrova  
S'di pse të dërgova më të marrën  
Pas së cilës si personazh Dostojevski  
Të thashë njëqind herë « më fal! »  
Më pas atë faj për të ndrequr  
Doja të të shkruaja por më kot.  
Lapsi më ngrinte mbi letër  
Dhe unë ngrija si robot.  
Ti u ngryse kur ta shpjegova,  
Vështrimi t'u err, t'u mpi,  
Si sytë e falltarit kur pikasin  
Midis fallit kumtin e zi.  
Diçka qe prishur në botë,  
Në zembrek të saj, në aks.  
Ikja e letrave si e zogjve  
S'parandillte veç dimrin plak.

## IV

Kështu pra të t'i nisja këto re  
Gjer në vilën tënde në rrëthinë të Moskës.  
Ti në mesnatë e hutuar atje  
Do të çoheshe nga gjumi,  
Tek qelqet t'afroheshe:  
Ç'ndodh kështu?  
Ç'është kjo gjëmë,  
Ky shi herë i mërzitur, herë i rreptë,  
Këto vetëtima,  
Këto rrufe?  
Dhe do të rrije gjithë natën tek dritorja  
Retë të deshifroje,  
Llora.

## V

Zor se në jetë do të takohemi.  
Adresat humbën,  
S'ka letra.  
Ti mjegullat,  
Unë retë  
Do t'i dërgojmë njëri-tjetrit  
Gjersa dhe vetë  
Të mjegullohemi.

## VI

Më kujtohet, gazetat hapa në mëngjes  
Si një tërbim, si një shkulm ere.  
Shkronjat vallëzonin si n'ethe:  
Prerje. Prerje. Prerje.

Prerje marrëdhëniesh diplomatike  
Kurre s'do të shoh ty.  
Ambasadat u mbyllën.  
Pasaportat,  
Vizat  
Ranë në zi.

Mbi ijet e tua të bardha  
Ra pluhur.  
Mbi sytë e tu.  
Larisa Diplomatiçeskaja,  
Ç'ndodhi në botë kështu?

## VII

Qëndrova përpara globit.  
Ballin e nxeh të mbështeta  
Mbi rrudhat e meridianëve.  
Do të desha të pija me globin,  
T'endeshim të dy të dehur,  
Ai mes kozmosit,  
Unë rruginave të Tiranës.

## VIII

Nga erdhi kjo dashuri  
Në kohën kur turp më vinte nga kjo fjalë.  
Ishte me siguri si ndëshkim,  
I atij që me tempullin tallet.

Njohja në stacionin Komsomolskaja  
Banale si rrallëherë ish.  
Numri i telefonit shkaravatir shkujdeshëm  
Me të kuq buzësh  
Barbarisht.

Restorant « Leningradi »  
Shampanjë,  
Snobizëm i dyanshëm,  
Kotni.  
Perlat, secili, pse vallë  
Përpiqeje t'i fshihte në thellësi?

Një të kollur si prej prostitute  
Ajo nxirrte orë e çast si mburojë,  
Ndërsa unë këmbëngulja se nga librat  
Merrja vesh më pak se nga futbolli.

Veç te portë e shtëpisë nën ca jargavanë  
Ajo psherëtiu njerëzisht.  
Dhe iku me vrap pas puthjes së parë  
E kthyer në madonë sërisht.

## IX

Gjithë mbrëmjen fluturuam mbi qytetet e Evropës.  
Natën avioni u ul n'aeroport.  
Ç'pati mes nesh,  
Llora,  
Harresë, ftohje, abort?

Tek dera e avionit era të priste.  
Zemra me dëborë m'u mbush.  
Si një vetmi e madhe  
Zbrisja,  
Por n'aeroport.  
Askush.

Askush.  
Hamej, merrini këto valixhe.  
Të rënda?  
Janë mbushur me pritje.

Gjithë natën fluturuam mbi qytetet e Evropës.  
Ti, s'dija ç'kishe, s'më prite.

## X

Në « Kafe Artistike » bashkë jemi prapë.  
Jashtë dëbora ruse.  
Brenda ti.  
Shkrofëtin brenda meje geni i racës:  
Prapë me sllaven bën dashuri.

Pusho, gen i vjetër i racës,  
Në thellësi, në humnerë hesht.  
Nëse jetës sime do t'i duhej një kryq,  
Kryqi im ajo le të jetë.

## XI

Dhe ja gdhiu mëngjesi plot gazeta.  
I ngrysur, shpresëpakë, shtetëror.  
Kemi flakur të dy mburojat,  
Si qelqi të thyeshëm jemi prore.

Ku janë ditët e shkujdeshme.  
Të dielat mendjelehta, të martat,  
Kur ti me shthurjen, unë me injorancën,  
Vërtiteshim si me maska?

Tani që të tjerët rresht vunë maskat  
Ne papritur i hoqëm ato.  
Fishkëlle, ulëri, erë e marrë,  
Orën e ndarjes këndo!

## XII

Ndarja...  
Një fjalë goje  
Por ndarja është e rëndë, shpirtin ta qit.  
Të ndërtosh një ndarje për të qenë  
Është më e zorshme se të ngresh një piramidë.

Si yjet janë vërtet dashuritë,  
Kërkojnë hapësira të mëdha e po aq mund.  
Por jetë e njeriut s'është galaktikë  
Që të nxerë kaq yje e katastrofa e shkrumb.

Në jetën e ngushtë koha vërtet s'mjafton  
Për dashuri,  
Për ndarje,  
Harresë.  
Plekzen dashuritë dhe ndarjet dhe harrimi,  
Këngëtor i thinjur shëtitës syqorruari...  
Era e nëntorit  
Librin e tretë të vjeshtës  
Shfleton dhe e mbyll duke ulëritur trishtuar.

Të gjitha këto rikujtoj  
Ripërtyp  
Në dhëmbë gurët e pendimit më kërcasin,  
Asfalti i zi më varet nofullave të lodhura.  
Kështu, pra, Larisa, moskovitja.  
Kështu, pra, Llora.

1961

## LOKOMOTIVA

1

Në bregun e shkëlqyer të detit,  
Në sfond të bardhë valësh, resh e rrezesh,  
Pranë pistave të dansit,  
Ndanë hotelesh e kaltërsish,  
Lëviz ti ngadalë,  
Njollë e zezë,  
Duke rënkuar mbi binarët,  
E rëndë, e ngrysur lëviz.

Lokomotivë e plazhit, lokomotivë e vjetër.

I çon mysafirët detit,  
I heq mysarifët detit.

Prodhuar më 1940 në Essen të Gjermanisë,  
Ndanë një deti të huaj po i ngrys  
Ditët e pleqërisë.

2

Je lodhur e plakur,  
Ofshan, djersin e nxjerr shkumë.  
Pas çdo udhe që bën

Lodhesh edhe më shumë,  
Megjithëse tërheq një peshë kaq të lehtë  
Siç është lumturia...  
Lokomotivë e zezë, lokomotivë e vjetër.

3

Pranë një deti të huaj  
Ç'gëzim vallë të ka mbetur,  
Veç këta çifte të rinjsh,  
Këto vajza të shkujdesura,  
Këta fëmijë që shkërbijnë zhurmën tënde të vjetër.  
Duke të ndjekur pas me britma e të qeshura.  
E megjithatë, ti këtu je e huaj,  
Një plaçkë lufte,  
Një njollë lufte e zezë  
Në këtë sfond të kaltër uji e rrezesh.

4

Si invalidi plak, që në luftëra u sakatos  
Dhe i gjallë pas luftërave diku mezi u sos.  
Dhe i japin pastaj një punë të lehtë,  
Ashtu dhe ti, lokomotivë e detit,  
Nga plazhi në qytet shërbën tanë,  
Për herë të parë tërheq kaq lumturi,  
Për herë të parë tërheq gjëra të kthjellta,  
Kaq gjëra të bardha  
Mbi trupin e madh, të zi,  
Lokomotivë e luftës, lokomotivë e ashpër.

Pranë detit të qetë, pranë dallgëve,  
Të kujtohet rinia kaluar mes flakëve.

Nga njëri skaj i Evropës në tjetrin skaj  
Nga njëri front në tjetrin front,  
Duke vrapuar me vërvshëllima, sirena e vaj,  
Nga njëri horizont i ngrysur në tjetrin horizont,  
Ti suleshe përparrë ditë e natë tutje,  
Duke klithur si shpend i egër,  
Duke i rënë borisë së luftës,  
Përmes peizazheve, gërmadhave, përndritjeve të zjarreve.  
Mes qytetesh, që bijtë ua merrje,  
Mes miliona duarve, qarjeve,  
Shtyheshe përparrë,  
Ulërije  
Sipër shkretëtirës së ndarjeve,  
Pas vetes  
Jehonat u lije hapësirave,  
Trishtimin binarëve.

Nën re, nën shi, nën alarme, nën avione  
Tërhiqje e tmerrshme  
Divizione, divisione.

Herë-herë,  
Nën shiun e mërzitur,  
Përmes gërmadhave,

Ktheheshe bosh nga frontet  
Vetëm me shpirrat e ushtarëve.

Me vagonat rresht të lagur nga mjegulla  
Dhe sipër një hënë ulëritëse.  
Ishin shpirrat e ushtarëve më të rënda se tanket,  
Ndaj ti gulçoje e ngrysur.

Ktheheshe trishtueshëm  
Dhe ulërima jote ishte më therëse,  
Dhe ngjaje e gjitha si një kllapi e zezë,  
Hamall i tmerrshëm i luftës,  
Lokomotivë e vdekjes.

7

Mos ëndërron prapë të sulesh si veri  
Rrugëve të luftës  
E hekurta shtazë,  
Tani që mbart e bie kaltërsi,  
Si invalidi plak,  
Që si mbarti murtaja në front  
Tani mbart e bie ujë në dasmë?  
Ti, që mbi supe mbajte vdekje, regjimente, ushtarë,  
Ndoshta të vjen turp që mban tani në krahë  
Buzëqeshje vajzash të nxira nga dallgët,  
Dhe vetja të duket ndoshta si një dado,  
Që ngre kaliboç nipër të huaj,  
Lokomotivë e zymtë, lokomotivë e ashpër.

Ndaj, kur vjen muzgu herë-herë,  
 Kur ti dremit atje në bregun me shkumë,  
 Në mes qetësisë së madhërishme  
 Lëshon ndonjë klithmë,  
 Sikur trembesh në gjumë.

Dhe me klithmë ndonjë nga shoqet të përgjigjet,  
 Dhe heshtni prapë  
 Në paqen e mbrëmjes sipër shinash,  
 Silueta të mëdha.  
 Në këtë orë të vonë,  
 Ju kap një mërzi e zezë lokomotivash.

Së shpejti do fillojnë anë detit shirat,  
 Do të mbyllen plazhet,  
 Do t'ikin kaltërsitë.  
 Gjethet e verdha do fluturojnë sipër shinave,  
 Do të bien ngadalë mbi shpinën e çeliktë,  
 Ti do të rrish pa punë  
 E vetme në breg të detit,  
 Ujërat do të shkëlqejnë mbi pjesët e rënda  
 Dhe ti do të qash me lot të fuqishëm  
 Pleqërinë tënde të zezë.

1962

## BUZËQESHJE MBI BOTË

1

Gërmadhat ereve poshtë shtrihen pa kufi,  
Shtylla, blloqe ajri të rrëzuara,  
Shkretëtirë.  
Poshtë reve bota nën dritëra dhe xhaz jeton,  
Në horizonte rrënimesh resh të hirta.

Fluturojmë mbi Evropë,  
Mbi qytete të mëdhenj,  
Qytete të mocme që tundin në erë  
Kulla, kambanore, kryqe të bardhë,  
Si qime të thinjura  
Që kurrë s'janë prerë.

E vjetër është bota,  
E parruar,  
Kaç shumë akoma duhet bërë.  
Nga pisllëku i vjetër për ta pastruar,  
Për ta rilindur të pastër të tërë.

Vendet n' avion i kemi përbri  
 Unë dhe një kapitalist plot dhjamë,  
 Stjuardesat  
 Drekën na sollën të dyve  
 Në duar pirun e thikë na dhanë.

Tani qytetet atje poshtë duken si pjatanca,  
 Që plot ndërtesa, stacione, muze brenda mbajnë.  
 Ai mori pirunin  
 Dhe mua m'u duk se  
 Si torta  
 Ndërtesar, stacionet, muzetë,  
 Bëhet gati t'i hajë.

Zhytur në kolktukë  
 Hamë drekë ne të dy,  
 Vërtitet mbi botë piruni i tij.

Erdhi mbrëmja.  
 Drejt nesh errësira vrapon e shpejtë.  
 Të kap një mall për shtëpinë,  
 Ku jemi, thua, ku.

Poshtë nesh  
Qytete të panjohura nisën të bëhen inkandeshentë.  
Dhe si prush i zbehtë  
Skuqin aty-këtu.

Këtë natë të ftohtë, të huaj, të largët,  
Duart të vjen t'i zgjatësh e t'i ngrohësh  
Mbi këto qytete  
Si mbi mangallë të largët.

4

Zbresim në errësirë,  
Papritur na shfaqet,  
Larë në drita verbonjëse,  
Aeroporti i mesnatës,  
Vijat e reklamave tendosen joshëse  
Si tatuazhe të kaltra në trupin e natës.  
Padashur të kujtohet dritë e zjarrit të vatrës  
Në shtëpinë e largët,  
Dritë e ndershme e vatrës.

Dhe padashur thua,  
Vallë ç'do të mendonte,  
Duke parë reklamat nëpër kate,  
Sikur nga avioni të zbriste sonte  
Prometeu  
Si pasagjer nate?

Mes erës së ftohtë të ecte në pistë,  
I zbehtë nga neoni fare;  
Unë zjarrin s' e vodha nga perënditë  
Për këto reklama lajkatare.

5

Uleimi në Kopenhagen.  
Bie shi,  
Ujërat rrjedhin në qelqet e mëdha n'aeroport.  
Në spikamën e ujërave  
M'u shfaqe ti,  
Flokëlëshuar,  
Dhe zemra më rrahu fort.

Ballin mbështeta në njërin nga qelqet pa kufi.  
Qelqe më rrëthojnë ngado,  
Qelqe djathtas e majtas.  
Dhe në të gjitha horizontet derdhesh e derdhesh ti,  
Flokëlëshuar si ky shi i Danimarkës.

6

Si barinjtë tanë, kur mbajnë në qafë  
Një dele të bardhë që e çojnë në vathë,  
Ashtu mbaj në qafë  
Një shall plot figura:  
Qafën time kanë shaluar  
Qytete dhe ura.

Në qafën time tunden degët e palmave,  
Kishat e Amsterdamin u bien kambanave,  
Parqe e muzera rrinë në radhë,  
Në qafën time  
Bota  
Si një dele e bardhë.

Për të gjitha këto unë vura qeleshe,  
Qeleshe mbi piramidat,  
Mbi Shën Mërinë e Parisit,  
Mbi koka racash të ndryshme  
Qeleshe,  
Sikur vura mbi botën  
Një buzëqeshje.

1962

## PATY

Ti ike udhës së pafundme,  
Ku zverdhin drurët gjetherënës.  
Mbi gjokse pellgjesh tani tundet  
I arti medaljon i hënës.

Lejlekët ikën. Fill pas teje  
Si stof i keq u zbeh blerimi,  
Dhe ngajnjë toka, pylli, reja,  
Me negativin e një filmi.

Tani në fusha shkoj menduar,  
Ku nis të fryjë erë e ftohtë,  
Ku ca mullarë të gjysmuar  
Duken që larg si donkishotë.

Ç’të bëj, po them me veten time,  
Në këtë orë të vonë të muzgut,  
Kur qerrja baltrave bën shkrime,  
Të lashta si të Gjon Buzukut?

Do shkoj të ulem përmbi pellgjet,  
Ti pi në gjunjë duke rënë.  
Në grykë e di që do më ngelet  
I ftohti medaljon i hënës.

1963

## KATARAKTET

Kataraktet kërcenin teposhtë,  
Si kuaj të bardhë, të vrullshëm  
Plot jele shkume e ylberesh.

Por befas te buzë e greminës  
Ranë me këmbët e para,  
I thyen, oh, këmbët e bardha.

Dhe vdiqën në rrëzën e shkëmbit,  
Tani në sytë e tyre të shuar,  
I akullt, pasqyrohet qelli.

1963

## POEMË VJESHTË

1

Si erdhi kjo vjeshtë kështu papritur, anembanë  
Ky ajër plot elektricitet,  
Këta stola të lagur parqeve.  
Veturat e një delegacioni kaluan shpejt me radhë;  
Gjëmimet u ndien tutje horizonteve të largëta.

Rojtarët e parqeve tani mbledhin karriget,  
I grumbullojnë këndeve,  
Ndanë pistave të shkreta.  
Në vendet bosh t'orkestrave dirigjon era  
Koncerте të verdha fletësh.

Telat e telefonave dhe të telegramave në hapësirë,  
Të nderura zgjaten drejt pafundësive.  
Nëpër telat e lagur, që çajnë qiellin e hirtë,  
Një telegram lamtumire  
Do t'u dërgoj kaltërsive.

## KATARAKTET

Kataraktet kërcenin teposhtë,  
Si kuaj të bardhë, të vrullshëm  
Plot jele shkume e ylberesh.

Por befas te buzë e greminës  
Ranë me këmbët e para,  
I thyen, oh, këmbët e bardha.

Dhe vdiqën në rrëzën e shkëmbit,  
Tani në sytë e tyre të shuar,  
I akullt, pasqyrohet qelli.

1963

## POEMË VJESHTE

1

Si erdhi kjo vjeshtë kështu papritur, anembanë  
Ky ajër plot elektricitet,  
Këta stola të lagur parqeve.  
Veturat e një delegacioni kaluan shpejt me radhë;  
Gjëmimet u ndien tutje horizonteve të largëta.

Rojtarët e parqeve tani mbledhin karriget,  
I grumbullojnë këndeve,  
Ndanë pistave të shkreta.  
Në vendet bosh t'orkestrave dirigjon era  
Koncerте të verdha fletësh.

Telat e telefonave dhe të telegramave në hapësirë,  
Të nderura zgjaten drejt pafundësive.  
Nëpër telat e lagur, që çajnë qiellin e hirtë,  
Një telegram lamtumire  
Do t'u dërgoj kaltërsive.

2

Dhe plazhet tani janë braktisur,  
« Turizmi » u zbraz.  
Rëra trishton nën valët anembanë,  
Lokomotivat me gjoksin e zi.  
Erën e qullur çajnë, duke vërvshëllyer si huliganë,

Përse fishkëllen lokomotiva hapësirave të pambaruara,  
Kaq të vështirë e paska gjiganti i zi  
Të tërheqë atë vagon,  
Ku mbështetur në dritare  
Rri një kokë e bukur  
Me një mendim në sy?

3

Dhe unë kthehem nga plazhi me tren,  
Kam në shpinë  
Një fotoaparat  
Të vogël, të zi,  
Ashtu si udhëtari, që ecën luginës,  
Me torbën e bukës  
Mbi shpinën e tij.

Në të kam copëra pamjesh të fiksuara.  
Copëra jete e kohe  
Të ndalura n'eter,  
Buzëqeshje të dashura,

Minuta të kristalizuara,  
Të gjitha të ngrira  
Si në frigorifer.

Në netët e gjata të dimrit të gjatë  
Do të nxjerr ç'ka brenda ky aparat.

4

Që nga tarraca e apartamentit  
Vështroj i qetë tutje  
Si ikin dallandyshet,  
Dhe qiellin me çarçafët e zhubrosur të reve,  
Si një shtrat pasionesh vigane  
Të shprishur.

Kështu të çrrregulluar qiellin e lanë  
Muajt e verës,  
Që na shkuan pranë.  
Së shpejti shiu do të qullë dhenë  
Me një monolog të gjatë, si në romanet modernë.

5

Retë  
Gjoksin e hirtë grisin  
Mbi tymtarët e hekurt të fabrikave që tymosin.  
Rrufepritëset  
Reve të rebeluara vetëtimat ua thithin

Dhe në gjirin e tokës së zezë  
Thellë i burgosin.

Tokë e fuqishme,  
E zezë, e *quullur*, metalike,  
Të ndiej si merr frymë thellë e jeton,  
Ndërsa retë e egërsuara i çarmatos,  
Krenarinë ua zbret,  
Vrapin ua sundon.

6

« Të shkulje vetëtimat me gjith' rrënjet nga retë,  
Si rrepat e kuqe nga balta,  
Të shkulje rrënjet e shirave,  
Të tufaneve të rreptë  
Dhe të borës,  
Rrënjet e kristalta.

Qielli të pastrohej si toka  
Nga barishtet e këqija,  
Të na shpalosej mbi koka  
Vetëm kaltëria. »

Kështu më thoshe një ditë  
Me një buzëqeshje të trishtë.  
Po a e di se qielli  
I mërzitshëm

Pa të gjitha këto  
Do të ishte?

Do t'i merrte njerëzit malli  
Për një re,  
Për një suferinë,  
Për vërtimmat do ëndërronin  
Si për një trëndelinë,  
Dhe i urryer do na bëhej  
Qielli meskin.

7

Zogjtë e fundmë që ende s'janë nisur,  
Si pasagjerë të vonuar  
Mbi tela qullen në shi  
E cicerojnë sikur thérresin:  
« *Taksi, taxi* ».

Unë me jakën e ngritur ndala në trotuar,  
Duke parë mbi tela  
Zogjtë qyqarë:  
Sikur, mendova,  
Polici për çudi  
Të ngrejë dorën,

Të ndalë taksi,  
Taxi për zogjtë,  
Për zogjtë taksi.  
Unë me jakën e ngritur ëndërrroja në shi.

Tani vetëtimat  
 Mbi shpinat e reve  
 Adresa të çuditshme shkaravasin  
 Dhe retë si zarfa të mëdhenj notojnë.  
 Si zarfa  
 Që stinët njëra-tjetrës ia nisin.

Dhe ç'kanë shkruar në to  
 Vetëm ato e dinë.  
 Ndoshta të shirave monotoninë.  
 Ndoshta të bubullimave dashurinë,  
 E histori qiejsh, që veç ato i dinë.

Prapë breshri kërcet në ballkon,  
 Era fryn e vrazhdë.  
 Laj edhe unë gjer natën vonë  
 Të fundit fotografi të plazhit.  
 Në solucionet e vjeshtës rishfaqen  
 Kujtimet që brigjeve lashë.

Fillojnë të duken një nga një  
 Ca re,  
 Një breg,  
 Një vilë;  
 Pastaj dallgë

Dhe, si me magji,  
Midis reve dhe dallgëve  
Shfaqesh ti.

Ti shfaqesh dhe ma bën me dorë  
Larë në mendimet vjeshtore.

*1959-1964*

## TË HUAJ JEMI

Të huaj jemi ne prej kohësh,  
Ç'ish për t'u thënë është thënë,  
Si gurët që zënë vend në tokë,  
Në jetë vend ne kemi zënë.

Drejt njëri-tjetrit kemi mbyllur  
Të gjitha rrugët edhe shtigjet,  
Si dy qytete mesjetare  
Me mure, heshta dhe me pirgje.

Por natën, kur i lodhur truri,  
Portat i mbyll me qetësi,  
Ti gjen një shteg dhe futesh brenda,  
Një shteg që vetëm ti e di.

Pastaj si në rrugica parqesh,  
Shëtit mes cirkovolucionesh,  
Hyn nëpër ëndrra e shkujdesur,  
Fanitesh, qesh, ma bën me dorë.

Po kur mëngjesi zë afrohet,  
Nis shqetësohesh befas ti,  
Dhe heshturazi del përjashta  
Nga shtegu, që veç ti e di.

E dita vjen. Rrjedh prapëjeta.  
Dhe ne të dy si dhe më parë  
Të ftohtë rrimë e të pamposhtur  
Si dy qytete mesjetarë.

1964

## EPILOG BREZAVE QË VIJNË

Ju do të vini në kohëra më të qeta,  
Shumë fjalë tonat pa kuptim kanë për t'ju dukur,  
Se shumë fjalë do t'i ketë zhdukur jeta,  
Ashtu siç, ndoshta, tigrat do ketë zhdukur.

Duke hyrë në gërmadhat e forta  
Dhe madhështore të poemave tona,  
Me logjikën tuaj të ftohtë  
Do përpinqeni ndoshta të na gjykoni.

Gërmadhat do të heshtin.  
Veç jehonën  
E zërit tuaj mbrapsht do kthejnë.  
Dhe një mijë herë sikur ju të gjykoni,  
Të një mijë herët zërin mbrapsht do kthejnë.

Kështu do ndodhë, në qoftë se drejt s'gjykoni,  
Pranë heshtjes sonë krenare pa kufi,  
Dhe në qoftë se rastësisht harroni  
Fjalët e zhdukura,  
Të zhdukurën borgjezi.

1964

## DIMRI

Dhe vjeshta shkoi, fletët e saj  
I vërtit era, i përpjek.  
Dimri si perandor kinez  
Ngjyrën e verdhë kudo e ndjek.

Dhe këto re që tani vijnë  
Ndryshe nga retë e gjertanishme,  
Të shkreta janë, pa vetëtima,  
Porsi djerrina të mërzitshme.

Porse nën to qyteti zien  
Me drita, zhurma dhe trafik.  
Dhe flokët e tymta të uzinave  
Mbi supe i bien madhërisht.

Ja horizonti i bardhë i dimrit,  
Përballe peizazhit që lëviz,  
Harxhon të fundit vetëtimë  
Si reporteri të fundit blic.

1965

## FUND VJESHTE

Autobusët urbanë nga periferitë  
Drejt qendrës mbi qelqe sjellin brymën.  
Vjeshta si luaneshë krifëverdhë  
Ruan ditët e fundit nga dimri.

Te vitrinat, te dyert e kafeve,  
Kalimtarë të shumtë ka.  
Në reflekset e flokëve të tu  
Një nuancë e kuqërremtë ra.

Pranë ditëve të tua të bardha  
Kalova sot rastësisht.  
Ti u trembe? Unë ujk nuk jam,  
(As dele nuk jam, natyrisht).

Po ti eja, atje të shkojmë,  
(Pa përfillur fjalët e botës),  
Ku nga avulli xhamat e kafeve  
Ngajnjë si pamje që s'janë në fokus.

N<sup>o</sup> autobusët urbanë eja,  
Të shkojmë periferive me brymë.  
Të shkojmë si vjeshta krifëverdhë  
Ruan ditët e fundit nga dimri.

1968

## TI QAVE...

Ti qave dhe më the me zë të ulët  
Se unë të trajtoja si prostitutë.  
Aherë lotëve të tu s'ua vura veshin,  
Të desha, pa e ditur se të desha.

Veç një mëngjes të beftë kur u gdhiva  
Pa ty dhe bota krejt e zbrazët m'u duk,  
Aherë e kuptova ç'kisha humbur,  
Ç'kisha fituar kuptova gjithashtu.

Më rrëzëllinte si smerald mërzija,  
Dhe lumturia ngrysej si një muzg me re...  
Nuk dija kë të zgjidhja nga të dyja  
Sepse secila m'e bukur se tjetra qe.

Se ish i tillë ky koleksion bizhush  
Që dritë e terr lëshonte njëkohësisht,  
Që njëqindfish etjen për jetën shtonte,  
Por dhe që vdekjen ndillte njëqindfish.

1970

## TE KËSHTJELLA E HAMLETIT NË DANIMARKË

Elsinor. Ç'akt është ky? Hyjnë turistë. Hyjmë ne.  
Sa shekuj kaluan që ty, princ Hamlet,  
T'u shfaq fantazma atje n'atë ledh,  
Atje n'atë ledh, nën hënën e zbehtë,  
Ti ngrive nga tmerri, princ Hamlet.

Veshët më dhembin  
Nga një zhurmë skëtëerre,  
Miliona kime kanë dëgjuar veshët,  
Tonelata helmi në to janë derdhur,  
Propaganda fryn si erë e parreshtur,  
Vër sa të duash pambuk në veshë.

Ekranet e TV-ve janë të kaltra sonte, janë të zbehta,  
Më të zbehta se fantazma e tët eti, Hamlet.  
Tregojnë ekranet për kime të hershme,  
Parathonë ekranet kime të tmerrshme:  
Çekoslovakia u gjet e vrarë në gjumë një mëngjes.  
(Oh, helmi në vesh, ç'është helmi në vesh).  
Përpëlitet Vietnam i prerë mespërmes  
(Oh, helmi në vesh, ç'është helmi në vesh).

Bota plot trupa të gjymtuar shtetesh,  
Gjokse, copa të prera skaj më skaj.  
Ja antenat sipër saj si skelete,  
Hapin krahët sikur thonë « s'kemi faj ».

Ti ende habitesh atje mbi ledh  
Nga tregimi i fantazmës, princ Hamlet,  
Kurse unë sonte në Ruajal Hotel  
Do të fle nën një çati me një krim, me një mbret...

Perandori Hirohito në Ruajal Hotel  
(Akti i fundit. Hyjnë oborrtarë, të TV-së reporterë)  
Në veshë dhembje,  
Zhurmë e paprerë.

Kush do ta vrasë sonte mbretin në Hotel Ruajal?  
Sonte spikerët janë të ngrysur, të zbehtë,  
Ja antenat para kohe thonë « s'kemi faj ».  
Propaganda fryn e shfryn parreshtur,  
Vër sa të duash pambuk në veshë.

Perandori Hirohito në Hotel Ruajal.  
Presin varg ekranet si të mpirë.  
Me thikë, me helm, me plumb? Jo, dhe jo,  
Perandori mund të bëjë harakiri.  
Do të dridhen telat, spikerët do të mbytin botën në vaj.  
Ah, Hotel Ruajal, u shofsh, Hotel Ruajal!

Fantazma të tregoi për një gotë helm, Hamlet,  
Seriozisht ti e more tregimin e saj.  
Por ç'ka bërë fantazma, kur ishte mbret,  
Ç'det me helm ka derdhur, ç'oqean me vaj?...  
Ja kështjellat ngrenë lart pirjet skelete,  
Sikur duan të thonë: s'kishin faj.

Nga emisionet e mbrëmshme ekranet janë të zbehta,  
Më të zbehta se fantazma e mbretit Hamlet.  
Të gjithë të vërtetën ekranet s'e thonë,  
Ashtu si fantazma në rrëfimin e saj.

Rrinë përpara tyre miliona Hamletë,  
Mallkojnë, dyshojnë, shaj dhe shaj.  
Lart antenat në qielin gri me erë  
Tundin krahët, sikur thonë: s'kemi faj.

Perandori Hirohito në Ruajal Hotel.  
Hipin, zbrezin ashensorët si në katet e skëterrës...  
Fantazmë llafazane, pa zbrit nga ai ledh!  
Krimet klasore dredhin botën si rrebesh,  
Mjaft me helmin në vesh!

*Kopenhagen, Royal Hotel, 1971*

## MUNDJA E BALLKANASVE NGA TURQIT NË FUSHËN E KOSOVËS MË 1389

Fusha e mbytur në gjak e kllapi shumëgjuhëshe shtrihej tutje.  
Bashkë me ditën, ballkanasit u thyen. Medet!  
Gadishulli i madh u għid Evropë e u ngrys Azi.

Gjëma vraponte rrafshnaltave, ikte grykave,  
Ato dot nuk e mbanin, ia kthenin maleve gulçonjës,  
Që e rroku llini pllajave, kérkonin ishuj pér t'ua ndarë,  
Po ishujt s'gjendeshin. Gjithċka qe bérē katrahurë.  
Furtunat nē qiej u hutuan, vërtiteshin si tē verbra.  
Plakeshin nē čast vetëtimat e binin nēpér baltéra.  
Qiejt po zhvisheshin. Mjerë ju, popuj tē Ballkanit.  
Mjerë ju gjuhështerpa, me mbaresa si shkopinj tē thatë,  
me alfabete tē përgjakur.

Si do t'ju djegë malli pér tē pjellë një vjershë. Medet!

Ç'gjak do tē derdhet pér tē ndrequr ç'u prish këtu.

Ra nata. Një qiell i panjohur u shtri mbi gjithċka, i ftohtë,  
Pastaj gjysmehëna doli e mori nē dorëzim gjithċka.

1975

## LAOKOONTI

Më shihni tek mbytem nga gjarpërinxjtë  
Në muze tē Luvrit, në Madrid, në Nju-Jork.  
Para syve tuaj e aparatesh turistësh  
Qindra vjet kam që vuaj, nagaqë s'flas dot.

Si tē flas? A mundet një nofull mermeri  
Tē lëvizë një grimë, tē qortojë diçka?  
Vini re sytë e mi, te zgavrat e thella,  
Një enigmë si amebë tē tharë atje ka.

Një tē fshehtë tē madhe ndrydh brenda gjoksit  
Para syve tuaj, në Paris, në Madrid.  
Ah, do doja gjarpërinxjtë dyfish tē m'i shtonit,  
Veç sekretin e madh ta shkarkoja një ditë.

Tek më vini rrrotull, unë them me vete  
Kaq tē verbër tē jeni, sa mos ndieni këtë,  
Që ky ngérç e ky ankth në gjithë qenien time  
S'është nga gjarpërinxjtë, po nga tjetër gjë?

Mijëra herë në mijëra net e ditë  
Të vërtetën e frikshme përsëris papushim.  
Me shpresën e marrë se nga kjo përsëritje  
Ndoshta mermari pëson një ndryshim.

Po s'ndërron ai kurrë.

Art i skulpturës

Gënjeshtren mbi mua ka ngrirë përgjithnjë.  
I mbërthyer në dëshminë e saj të përeme,  
Të vërtetën kujtoj dhe qaj për të.

Si çdo gjë e tmerrshme, është i thjeshtë sekreti,  
Që brenda boshllëku i gjoksit tím mban.  
Afroni, pra, kokat të dëgjoni të vërtetën,  
Mua s'më mbytën gjarpërinjtë, po trojanët më vranë.

O sikur të mundja gjithçka të tregoja,  
Si do të ngrinit para meje si gur,  
Por unë jam i dënuar mes rropamës suaj  
Moskokëçarëse, monologun të thur.

Ju e dini se përpara Trojës aherë  
Kali i drunjtë, dhuratë e grekëve u shfaq.  
Ky kalë në dy grupe i ndau trojanët:  
Ta pranonin atë ose ta flaknin sakaq.

Pajtim me armikun, ulerinin tradhtarët,  
Mjaft më me luftë, zjarre dhe helm.  
Erdh' koha që shpatat t'i kthejmë në parmenda,  
Armiqtë në miq erdh' koha t'i kthejmë.

Në mbledhje të gjatë « pro » dhe « kundra » kalit,  
Unë « kundrat » kryesova me tërbim.  
Dhe juve ju kanë thënë se aherë hyjnitë  
Gjarpërinxjtë më dërguan si ndëshkim.

Ç'përralla kalamajsh, ç'trillim për budallenjtë.  
Unë gjarpërinxjtë do të sprapsja me një shkelm.  
Po ç't'i bëja fushatës së tradhtarëve kundër meje,  
Shantazheve, letrave anonime plot helm.

Ditë e natë e me javë polemika vazhdonte  
Nga shtresat e mesme gjer lart në qeveri.  
Ishte vjeshtë.

Nën qiellin e hirnosur me erë  
Kali i drunjjtë përjashta priste në shi.

Atë kalë unë i pari e kisha goditur,  
Ndaj, e dija, këtë s'do ma falnin përjetë.  
Më në fund « vijë e butë » fitoi mbi « të ashprën »  
Dhe ne, « kokëfortët », na vunë në arrest.

Në burg, me gotën e ujit, në mesnatë  
Helmin më dhanë ata të pi,  
Ata që ulërinin kundër dhunës dhe shpatës,  
Që dinin të kafshonin tamam si gjarpërinj.

Në mëngjes që pa gdhirë në breg të detit  
Ma hodhën kufomën drejt mbi zhavorr.  
Rapsodët aherë anembanë përhapën  
Versionin fals të gjarpërinxje hyjnorë.

Ky ishte mbarimi i polemikës për kalin,  
Ju e dini me Trojën ç'ndodhi pastaj.  
Tre mijë vjet rrresh,

ngä muzeu në muzera,  
Unë hamalli i mermertë gënjeshtrën mbaj.

Tre mijë vjet... Akoma zjarret e Trojës  
Si floknajë e kuqe më rrinë në sy,  
Po më i tmerrshëm se zjarret, kujet e vomet,  
Ishte fundi fare.

kur u bë qetësi.

## Trojë e braktisur

## Gërmadhë.

Hi i ftohtë,

Dhe poshtë ne të vdekurit shtrirë  
rresht.

Dhe papritur, në muzg sipër tokës së mardhur  
U ndje diçka që atë çante përmes.

Ç'ish kjo gërvimë kështu, kjo jehonë.  
Vumë veshin. Kuptuam. Grekët e ligj  
Përmbi qendrën e qytetit me parmandë lëronin,  
Për të thënë se Troja përjetë vdiq.

Ja më në fund dhe parmenda e tyre.  
Ah, plugu i saj si na çante më dysh.  
Nga tradhti e Trojës, nga gjithë dhembjet,  
Ky kafshim i parmandës m'i hidhuri ish.

T'i kthejmë shpatat më në fund në parmenda.  
Kështu thërrisin atëherë ata.  
Midis fjalëve tuaja, si mallkim, si gjëmë  
Veshët më kapën dhe këtë hata.

Më kanë lodhur më shumë, besomëni, ca fjalë,  
Se kjo peshë e neveritshme gjarpërinjsh.  
Ju, që gjer në hënë keni shkuar, si vallë  
S'depértoni dot gjer në gjoksin tim?

Gumëzhima juaj si zhaurimë deti  
Më vjen nga çdo anë, më përplaset në vesh.  
Nga copëra bisedash shumëgjuhëshe rrëth meje  
Shqetësimet e mëdha të botës marr vesh.

Dëgjoj emra shtetesh të reja që kanë dalë,  
Emra kombesh e popujsh të rinj dëgjoj,  
Veç ai, i vjetri, i tmerrshmi kalë,  
Ashtu si aherë ka mbetur njëlloj.

Prej potkonjve të tij unë rrëqethem akoma  
Dhe kështu në mermer i mbrojtur siç jam,  
Kurse ju, të pambrojturit, ju prej mishi dhe kocke  
Vërtiteni mospërfillës nga salsa në sallë.

Vërtiteni,  
Flisni për teatrin e për plazhet,  
Për gjithfarë motorësh e gjithfarë qeverish,  
Pa ju shkuar mendja se ai mund të shfaqet  
Në një ditë të rëndomtë, një mëngjes me shi.

Ashtu si aherë...  
Po mjaft, u lodha.  
Nga vërtitja juaj po më erren sytë.  
Nga rropama juaj veshët më gjëmojnë  
Në muze të Londrës, në Luvër e Madrid.

Në më pafshi ndonjë ditë të bëhem copëra  
Nga marazi, siç thonë, të plas, t’ia bëj « krak »,  
Jo kujtimet e Trojës, as gjarpërinxjtë monstra,  
Por shpërfillja e juaj  
do të bëhet shkak.

1975

## MËSUESET E FSHATIT

Në udhëkryqe, ndan' xhadeve  
Ditët e shtuna dalin shpesh,  
Dhe zgjatin dorën nga makinat,  
Herë dy nga dy, herë veç e veç.

Por shpesh ata që janë brenda  
Me njëri-tjetrin shkëmbejnë fraza:  
« Si shumë pretendime kanë,  
Mor shoku Jani, këto vajza. »

Dhe janë ata që bëjnë zhurmë,  
Që kanë për vete dyzet gojë,  
Që i shkruajnë letër Presidiumit  
Për një kuzhinë, po t'ju mungojë.

Dhe ato presin makinë tjetër,  
Atje në rrugë, atje në shi.  
Ato, të urtat gjer në dhembje,  
Të thjeshtat gjer në madhështi.

Tek presin, java që kaloi  
U rikujtohet si në tym,  
Klasa me nxënësit, gabimet  
Q’u përsëritën në hartim.

Në mbrëmje radion dëgjon njëra,  
Tjetrës ndër mend i vjen sërisht  
Shikimi i fotoreporterit,  
Q’andej kaloi rastësisht.

Kohë e fejesës i ka ardhur,  
Dikujt dhe ndoshta i shkon çdo ditë...  
Pluhur i shkumësit, vello e bardhë  
U bie mbi supe i trondit.

Po s’ngrenë ato botën në këmbë,  
Në komitet, në ministri.  
Ato të urtat gjer në dhembje,  
Të thjeshtat gjer në madhështi.

1976

## MALL

Ca pika shiu ranë mbi qelq.  
Për ty unë befas ndjeva mall.  
Jetojmë të dy në një qytet,  
Dhe rrallë shihemi, sa rrallë.

Edhe m'u duk pak e çuditshme  
Si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes.  
Qiejt e ngrysur pa lejlekë  
Dhe shirat pa ylberë në mes.

Dhe thënia e vjetër e Heraklitit  
Seç m'u kujtua sot për dreq:  
« Të zgjuarit janë bashkë në botë,  
Kurse të fjeturit janë veç ».

Në ç'ëndërr kemi rënë kaq keq,  
Që dot s'po zgjohemi ne vallë?...  
Ca pika shiu ranë mbi qelq  
Dhe unë për ty seç ndjeva mall.

1976

## KRISTAL

Ka kohë që s'shihem i dhe ndjej  
Si të harroj un'dalngadal,  
Si vdes tek unë kujtimi yt  
Si vdesin flokët dhe gjithçka.

Tani kërkoj unë posht'e lart  
Një vend ku ty të të lëshoj.  
Një strofë a notë a një brilant  
Ku të të lë, të puth, të shkoj.

Në s'të pranoftë asnjë varr,  
Asnjë mermer a morg-kristal,  
Mos duhet vall' prap' të të mbart  
Gjysmë të vdekur, gjysmë të gjallë?

Në s'gjetsha hon ku të të hedh  
Të gjej një fushë a një lulnajë  
Ku butësish porsi polen  
Gjithkund, gjithkund të të shpërndaj.

Të të mashtroj ndoshta kështu  
Dhe të të puth e t'ik pa kthim  
Dhe nuk do dimë as ne, askush  
Harrim ish ky a s'ish harrim.

1979

## BJESHKËT E NAMUNA NË DIMËR

As zog, as vetëtimë  
Gjëkund syri s'has.  
Ngrirë gjithçka. Ëndërr  
Veshur në kuarc.

Si në hotelet e shtrenjta  
Ku shtegtari s'hyn,  
Shiu dot s'i afrohet  
Luksit alpin.

Shkëmbinj si tempuj  
Nën re, mbi re.  
Një varrezë bubullimash  
Kujdes, nën këmbë ke.

1980

## ARDHJA E VJESHTËS

E pandryshueshme si përherë  
Ia mbërriti vjeshta përsëri,  
Modifikime avionët patën,  
Po krahët e zogjve, kurssesi.

Ndryshim nuk pati as modeli  
I fletës që te parku ra.  
Gjithçka përreth kërkon kujtesë  
Dhe për kujtesë mall veç ka.

Te hyrja e teatrit prapë  
U shtynë për biletë të fundit.  
Në prova regjisori iu klith  
Njëlloj Cezarit si dhe Brutit.

Pas një rrëmuje gazmore shqote  
Si grua e re krehur sakaq,  
Që një karficë vë mes flokësh,  
Me një ylber dita u shfaq.

1980

## BALSAMOSËSIT E ÇMENDUR

Balsamosësit e vjetër nga provinca Kun-Lin  
U nisën për udhë të largët.  
Rrugës për Pekin, acari të ngrin  
Atje, thonë, ka vdekur kryetari.

Balsamosës më të mirë nuk gjen se ata  
Në kohërat e sotme moderne.  
Njëri trupin di të zbrazë, tjetri kafkën ka,  
Lëngun di të përgatitë i treti.

Ecin dhe të lumtur tani janë krejt  
Që trupin pa jetë të kryetarit  
Megjithëse prej kohësh të sëmurë dhe pleq  
Atyre ua besuan së pari.

Kaq kohë të trishtuar ishin të tre,  
Asnjë ftesë nga Pekini s'vinte.  
Siç duket s'ka më të pavdekshëm mbi dhé,  
Herë njëri, herë tjetri psherëtinte.

Ja Lin Bjaq vdiq, vdiq Çu En Lai,  
Por prapë ata nuk i ftuan.  
Nëjri shkrumb, tjetri pluhur n'erë u shpërnda,  
Një në Kinë, një në vend të huaj.

Do të vdesim, siç duket, pa balsamosur kënd,  
Psherëtinin në muzg pleqtë,  
Gjersa vonë një mbasdite me një trok të rëndë  
Korrieri nga Pekini erdhi.

Dhe u nisën tre pleqtë e çmendur larg  
Rruga zgjat nëpër dimra, nëpër vjet...  
Njëri trupin di të zbrazë, tjetri trurin ka,  
Lëngun di të përgatitë i treti.

1980

## MËNGJES DIMRI NË PLAZH

Tryeza e pambledhur ashtu siç mbet pas darket.  
Nga filmat e së shtunës të lodhura janë ekranet.

E diela që nga rëra mbi perde përsëritet.  
I shkretë është plazhi jashtë, ku erë e dimrit ndihet.

Kursyer dielli i dimrit përmbi guaskat bie  
Si copërat e servisit që rastësisht u thye.

1980

## RËNIA E DËBORËS

Ty ndoshta nuk të shkoi ndërmend  
Se qelli rastësisht s'u mbyll  
Se kjo dëborë që shtroi kudo  
Në të vërtetë ra për ty.

U projektua çdo kristal  
I saj në qelli të madh diku  
Dhe nuk pushoi së rëni ajo  
Gjersa i gjjeti flokët e tu.

Që ti ta shkundje me një gjest  
Shkujdeshëm krejt e gjithë gëzim  
Një natë të tërë qelli punoi  
Me ernat në bashkëpunim.

Dhe në mëngjes i zbehtë ai,  
I ftohtë hapej madhërisht,  
Ndërsa shëtisnim ne të dy  
Nën altruizmin e tij të hirtë.

1980

## FLUTURIMI I PATAVE TË EGRA NË FORMË V-JE

E krijuan shkronjën  
E vetme që dinë:  
V-në superbe  
Dhe u nisën fluturim.

Dička lënë pas  
Dička marrin mbi re.  
Faleminderit, pata,  
Për aq sa bëtë pér ne.

Me një shkronjë të vetme  
Në qiellin e madh  
Sa një raft librash  
Na zguuat mall.

1980

## MARS

Ajri ngrohet nga pak  
Po mbasditeve bën fresk.  
Mbërrijnë zogjtë befas  
Si me teleks.

Në lajmet e botës  
Ka shqetësim jo pak.  
Mbi çatinë e shekullit  
Një ylber rri ndërkaq.

Si mëngjes i bruztë.  
Pa ankthin që iu prish  
Vjen fundi i mijëvjeçarit  
Pa apokalips.

*1981*

## AFRIM DIMRI

Në qielj ja u nis një tufë rosash t'egra.  
I fundmi ar i vjeshtës u shua e më s'u ndez.  
Dhe dimri po afron me grinë e tij funebre.  
Me ngricë e me acar dhe një plenum në mes.

Ç'spastrime do të bëhen, për kë vallë ora ra?  
Por le të ndodhë ç'të dojë, le të shpërndahen n'erë.  
Byrotë politike si puplat në një gjah,  
Veç ti të jesh për mua ajo ç'ke qenë përherë.

Tek zjarri në oxhak të rrjmë pranë mermerit  
Në studion dimërore kur qelqet shiu rreh,  
Ku heshtin varg kolktukët në madhështi funebre  
Ndaj zallahisë së kohës të shurdhër si dhe ne.

*Pogradec 1983*

## MONOLOG

Në natën plot acar një zjarr desha të ndez  
Por, nata ish e ftohtë, ah, ç'tmerr i zi që ish,  
Ndaj që të mbahej gjallë ky zjarrth n'atë rrebesch  
Diçka përherë kërkonte, kërkonte vazhdimisht.

Ndaj si shtegtari murg, që shkarpat mbledh në terr,  
Unë hidhja n'atë zjarr gjymtyrët pa pushim.  
Por ishin pak ato, ndaj fill pas tyre rrësht  
Mbi të nisa të hedh copëra të shpirtit tim.

Se s'bëhej ndryshe, dot, se s'bëhej ndryshe, eh,  
Se duhej që dikush ta mbante atë flakë.  
Në flakëzën-delir që veç vajsosja sjell  
Të frikshme pamje ndritnin e dridhesin përqark.

I shihnit vallë ato, dallonit vallë diçka  
Ndërsa rrëth meje nata me terr e ujq u mbush.  
Se donin që të gjithë ta fiknin atë zjarr,  
Dikush me ligësi e me padije dikush.

Të tjerë majë kodrash ku dielli kishte rënë.  
Të tyret zjarre ndrisnin dhe qeshnin që përtej.  
Se s'donin të kuptionin se ç'bëqej këtu brenda.  
Se ç'fli kërkon një flakëz që lindet në një terr.

I lodhur nganjëherë kam thënë: shuhu pra,  
Në qoftë se nuk të duan, të bjerë natë e pafund.  
Të verbtit sytë tuaj kështu ndoshta do t'jenë  
Në terrin absolut pa shqetësim kurrkund.

Po prapë diçka më shtynte të ngrihem si somnambul,  
Si murgu shkretimtar që shkarpat verbtaz mbledh  
Dhe sipër zjarrit prap' të hedh gjymtyrët akull  
Dhe copërat një nga një të shpirtit tim të hedh.

1984

## ROMANVRASËSI

Në presidiume, midis shefash  
A nëpër mbledhje pak më rrallë,  
Ti shfaqesh thjesht e buzëqeshës  
Dhe sytë i mbyll dhe flet ngadalë.

Dhe thonë shefat: sa i thjeshtë,  
Dhe thonë njerëzit: ç'babaxhan.  
Kështu shpërndahet kjo legjendë  
N'auditore anembanë.

Kështu shkon dita... Por vjen nata  
Kur në tryezë rri, oh, ç'tmerr,  
Lëkurën befas heq si maskë  
Dhe një fytyrë tjetër del.

Dhe letrat hap, çantën e krimit,  
Jo më për prozë lapsin zë,  
Por për të shkruar denoncimin,  
Për të varrosur prapë dikë.

Dhe shkruan fjalët: « ekuivoke ».  
« Ka aludim », « kuptim dyfish »,  
Ndërsa e ndien si spërkat duart  
Gjaku i romanit që jep shpirt.

Makbethi tha dikur: s'e prisja  
Të kish kaq gjak Dunkani plak...  
Por një roman nga plagët shpuar  
Nxjerr shumë e shumë më tepër gjak.

Ndaj nga spërkatja e tij nuk mundesh  
Nuk mundesh kurrë të shpëtosh dot...  
Më kot vë maskën në fytyrë  
Dhe buzëqeshjen vë më kot.

Dikur kinezët mu në këmbët  
E varrit të heroit q'u tret.  
Varrosnin vrasësin që bashkë  
Lavdi e turp t'ishin përjetë.

Do të kujtohesh dhe ti mbasë,  
Por veç nën këmbët e dikujt  
Do çajnë shekujt kështu bashkë  
Lavdi e tij dhe i yti turp.

1984

## DRERI

O drer i lartë me ata brirë gjer në yje,  
Ndjekur nga qentë ikën, ikën, ikën.  
Sa herë kokën shkund, rrëzon prej qiejsh  
Copëra dëbore e kristalesh pikë-pikë.

Porsi parmandë brirët e tu lërojnë  
Veç lartësitë e ngecin në to prore.  
Fije viskoze yjsh e brumë kometash,  
Ethe agimesh boreale e horoskopë.

Por qentë s'duan t'ia dinë, ata veç lehin,  
Rreken të të rrëzojnë e ti prapë ikën,  
Nën yje mospërfillës.  
Më shumë se qentë  
Kjo mospërfillje qiejsh ty të pik.

1984

## PAS DARKE

Qelqet e lodhura të gotave  
Rrëzëllojnë zbehtë. Më pas  
Gjithë natën mallëngjyeshëm do kujtojnë  
Buzë të bukura grash.

Në mëngjes te lavamani i bardhë  
Ujët do të vërshojë me furi  
Dhe qelqi, si pas heqjes së kujtesës,  
Do të ndritë, steril, përsëri.

Ndonëse, ndoshta, po ta shohësh me kujdes  
Një spikamë do të ketë mbetur i zbehtë.  
Sa darka do të duheshin vallë  
Për të ngallur të akulltin qelq?

Sa dihatje, frymëmarje, buzë  
Të bukura grash... Ku ta dish  
Por gjatë udhës drejt ndërgjegjësimit  
Qelqi do të thyhej natyrisht.

Dhe në rënien e tij kristalore,  
Në përnditjen e fundit tek plas  
Do të ketë si ofshamë të fundit  
Të qeshura e lotë grash.

1984

## NË STUDION DIMËRORE

1

Befas dritaret u trandën, jashtë po ndodhte diçka.  
U afrova të shoh, gjëmimet vallë ç'qenë.  
Gjethe të rrëzuara, si krahë zogjsh, në një hata.  
Dhe një breshër si shtresa perlash mbulonte dhenë.

Ç'janë ato zonja, vallë, që shkundin qafat, atje lart,  
Që si breshër shkundin perlat, stolitë?  
Diçka ka ndodhur, pa dyshim diçka  
Në tokë, në qiell, në shpirtra.

Diçka ka ndodhur?  
Veç te ti përherë  
Në trurin tënd e jashtëzakonshme ngjan gjithçka.  
Kurse në të vërtetë  
Dimri erdh' në derë  
Kjo veç ka ndodhur e gjë tjetër s'ka.

Flokët gjysmë të ngrirë,  
 Të ftohur krejt  
 Si nga qendra e dimrit  
 Ti erdhe drejt.

Ca kokrriza breshëri  
 Solle me vete që jashtë.  
 Që kishe diçka nga qielli  
 Kjo dukej haptas.

Diçka nga dritë e tij  
 Opake, enigmatike.  
 Kokrrizat e breshrit  
 Shkrinin pikë-pikë.

Kështu fjalët e tua  
 Shndërroheshin në dënësë  
 Për të ngrirë sërish  
 Në frizerin e kujtesës.

Përskaj raftesh të bibliotekës së bardhë  
 Pasi ike, unë qëndrova në qoshe  
 Hija e mbretit Hamlet u shfaq  
 Dhe u zhduk ngaqë s'ishte e nevojshme.

Deliri shumëgjuhësh i Xhojsit  
Më ofron shërbimin e tij.  
E gjatë është pasditja, më thotë,  
Në punë mund të të hyj.

Ç'dialogë të dashuruarish, të ndarësh,  
Ç'letra, ç'memuare të hap?  
Ja gjysmëpërçart murmurisin në qoshe  
Zelda dhe Skot Fitzxherald.

Por unë largohem më tutje  
Në rafte të tjerë ik  
Më fal, Volodja Majakovski,  
Më fal, dhe ti, Lili Brik.

Kaloj ngadalshëm bri raftesh  
Kë do doja të ngjallej sërish?  
Të pyesja përferrin Danten?  
Gjithçka e ka thënë imtësisht.

T'i bëja ndoshta Eskilit,  
Një naive, vulgare, pyetje:  
Më të mira ishin dramat që humbën,  
Nga ato që kanë mbetur?

Iki më tutje, e pafundme  
Prej tyre më ngjan kjo dhomë.

Ja Pushkini, hapat i ndal:  
Për Ana Kernën tregomë.

Ndonjë ditë pa dyshim ka ardhur  
Në flokë me kokrriza breshri?  
Më trego shkrirjen, dënesën  
Dhe kthimin pastaj në perla.

Me trego atje thellë nën tokë  
Poeti ditët si i ngrys,  
Atje ku nuk mbërrin lavdia  
E as turpi, natyrisht, nuk mbërrin.

4

Porsi çifuti i kthyer në fé tjetër  
Ia behu shiu i konvertuar në breshër.

Sa herë shiu në qelqe do trokasë  
Ti do të vish këtu dhe në mos ardhsh.

Qofsh si muzikë, si pikëllim apo si kryq  
Unë do të njoh e do të çohem vrik.

Dhe si ai që guaskës perlën ia merr  
Nga muzika, kryqi a vdekja do të të nxjerr.

1985

## KOHA E PAMJAFTUESHME

S'kam kohë të harroj shumë gjëra,  
Që nga mendja t'i nxjerr përjetë.  
Për tragjikët e vjetër dhe shkrepëtimat  
Do t'më duhen së paku dy vjet.

Dhe ndoshta po aq për Danten,  
Për frëngjishten tok me plazhet po aq,  
Ndoshta gratë do të jem duke fshirë,  
Kur muzgu do t'afrohet ndërkaq.

Si udhëtari me peshë të tepërt  
Para avionit që niset pas pak,  
I ngarkuar rëndshëm ende  
Do t'afrohem te varri humbak.

Nga supet si ta heq këtë barrë,  
Ku ta hedh këtë peshë, si?  
Me të s'mund të zgres atje poshtë,  
Por as lart dot s'e lë kurrsesi.

I munduar gjer në çast të fundit  
Nga mosthënia, nga pengu tragjik,  
Një shenjë ndoshta të pakuptueshme  
Do t'ju bëj të gjithëve e do t'ik.

*Pranverë 1990*

## AEROPORTI I MESNATËS

Nuk zbres por pllakos si katastrofë n'aeroport të mesnatës.  
Prej shkrumbit gjithçka rrëth u nxi, pistat ngajnjë si hon.  
Në panik dritëzat rendin, të kuqe, ngjyrë vjollcë, të kaltërtë.  
Plekzen, përgjaken dehshëm, kurora me gjemba sajojnë.

Një të tillë kalimthi rrëmbej, mbi krye e ras si i marrë.  
Kush vallë tek toka më shiti, tek baltë e mërzitshme e saj?  
Botues e policë së bashku qielin kërkojnë të ma marrin.  
Radari, judë i penduar, tund krahët e klith se s'ka faj.

*Paris, nëntor 1991*

## ORA E LIGË

Është orë e ligë kudo,  
Vallë a s'e ndjen?  
Era si me bronshit në brinjë  
Ndër metro vërshëllen.

Grafititë më shpejt se TV  
Shpërndajnë një lajm.  
Si me fyt të prerë një tren  
Tjetrin ndjek nëpër pjalm.

Është orë rreziku, nën thikë  
Një komb pret i shtrirë.  
Si peshkop i trishtë horizonti  
Thërrret për mëshirë.

Një shtet klith për ndihmë, një tjetër  
Në gjumë fqinjin vret.  
Nga klinikat e thyera tutje  
Erë e ftohur ngarend.

*Paris, nëntor 1991*

**DIMRI NË EVROPËN E BASHKUAR.  
REFUGJATËT SHQIPTARË**

Si zogjtë e qyqes shpërndarë anembanë  
Ata që bij të shqipes qenë gjer dje,  
Të lodhur nga gjithçka, nga trenat, vizat,  
Dhe nga kontrolllet q'i gjëmojnë si pré.

Vërtiten, qiejt janë të huaj prore.  
Qytetet drita plot, pa gjurmë dhembshurish.  
Nga balta e lodhja të rënduara krahët  
E zogut mbretëror, gati po thyhen më dysh.

Duhet t'ikin q'andej ku mezi mbërritën.  
Të vijnë atje ku ikja ëndërr ish.  
Mëdyshjet shpirrat kështu ua sfilitin,  
Tek rendin midis shtetesh e kufijsh.

Shkabën sovrane e kërkojnë ndër qiej  
Të vijë të mbledhë shtetasit e vet...  
Por qelli s'jep asgjë, e aq më pak  
Shqipen dykrerëshe veç në ethe e jep.

*Paris, 1992*

## KRISHTLINDJET NË NEW YORK

1.

Stuhi dëbore në New York, avionët gjithë vonojnë.  
Në qiejt lart diçka nuk shkon, dikush po mbyt dikë.  
Janë ernat ndoshta që s'merren vesh, radarët janë nervozë.  
Një puç qiellor ka ndodhur ndoshta e ne nuk dimë asgjë.

Ne si pérherë asgjë nuk dimë, ndërkaq në aeroporte  
Në salla pritjesh gratë nxjerrin pasqyrëzat me ngut.  
Parfumi i vënë qysh në mëngjes në trup të tyre shqetësohet,  
Errësimi i ëmbël mbi pubis besimin prore e humb.

Shtjellë dëbore. Rrokaqiejt ngjasojnë si të dehur.  
Do të besosh se e humbën peshën, si retë do ngrihen lart.  
Ne si pérherë asgjë s'kuptojmë, ne prapë drejt krimit rendim.  
« Ah, ç'kohë e keqe! » përsërisim si papagaj të ngratë.

2.

Avioni lejohet të zbresë më në fund.  
Duke shkërbyer engjëjt flatron sërish.  
Mbi rrakaqiejt shenjat e kryqit  
Të zotin e presin të zbresë lartësish.

Kurrikund në botë bujtësin e largët  
S'e presin kaq dehshëm e me kaq bujë.  
I varur humnershëm midis tokës e qiellit  
Midisësi i madh dëgjon « alelujan ».

Vallë kujt i përket, ka plot dy mijë vite  
Që enigmën e hershme s'e gjejmë ne dot.  
« Ndorë të qiejve », tha toka kur lart e ngjiti,  
« Ndorë të tokës » tha qielli kur e zbriti poshtë.

Ai mbeti në mes: shestimi ynë i thyer,  
Ndërgjegja e vrarë, fluturimi që vdiq.  
Eshtë vonë që qielli prapë ta tërheqë,  
Eshtë vonë që toka ta tretë në gji.

Eshtë vonë për të gjithë... Ndaj na sheh pikëllueshëm.  
Vdekjejetshëm tek mërzitet njeriu-hyjni,  
Dëshmitar i një pakti, i një bese të thyer,  
I ëndrrës sonë tragjike për qiellsi.

3.

Qielli ngryset më shumë. Dyer makinash përplasen.  
Ndriçimi që dita me ngut e tret  
Shpejton të strehohet në gurë unazash,  
E në qafa grash, në Avenunë e Pestë.

Eshtë ora e diamanteve. Në Blumengdale  
Ngadhnjimi i tyre vezullon që larg.  
Krenarë pa dyshim që vdekjen s'e njohin,  
Ndonëse jetën gjithashtu s'e njohin aspak.

Qielli nxin. Ora jonë po bie. Nën panikun  
E kambanave të saj dyndemi gjithkund.  
Te Ruga Dyzetedy, te kishë e Shën Patrikut  
Ne apostujt, gjykatësit, judët e pafund.

Ecim nën ca shenja e shigjeta ndonëse e dimë  
Se një rrugë veç njohim: atë që çon në mort.  
Të vetmin në botë që të dy kahjet i kishte  
E mbytëm, e tanë i themi: kthehu, Zot.

Kthehu, bir i Zotit, na trego drejtimin.  
Zbërthena shenjat që s'i marrim vesh.  
Humnershëm ai hesht e në vend të përgjigjes  
Si drita semaforësh katër plagët i ndez.

4.

Pushoi stuhia në New York, avionët me kohë mbërrijnë.  
Në salla pritjesh s'ka më frikë, parfumet s'vuajnë më.  
Atë që ndodhi sipër nesh, ne natyrisht s'e dimë,  
Çfarë u përbys e çfarë u ngrit, ne prapë s'dimë asgjë.

Ne shohim veç emblema bankash nën qiellin e hirtë,  
Ca « Dow Jones », ca « Dax », ca shifra që shfaqen si në  
makth.  
Në kartat tona të kreditit kërkojmë plagët e Krishtit,  
E shenjat tona, që mes shifrash e zeroš rrjedhin gjak.

Ne s'dimë ku i morëm plagët, ku ramë e ku u thyem.  
Afatet tona ne s'i dimë, verdiktin aq më pak.  
Ndaj n'aeroporte rendim prapë, me shpresë të gjejmë prapë  
qiellin,  
Por tokë e rëndë nuk na lë, s'na lë e zeza baltë.  
Ne pjellë e saj, robër të saj, mbretër të saj të rrëmë,  
Gjer kur i themi do na mbash në kurthin tënd të zi.  
Ajo s'përgjigjet, veç në heshtje, ashtu siç gatit barin,  
Për pabesinë tonë gatit ndëshkimin tonë të ri.

*New York-Paris, 1997*

## PËRMBAJTJA

<i>Revoltë e heshtur përmes lirizmit</i>	5
FUSHA SHTRIHET E ERRËT	13
MBRËMJA E FUNDIT NË MOSKË	14
PIZHAMET DHE AEROPORTET	15
IKJA E MOJSI GOLEMIT	17
KËNGA E MILLONAIT	21
LLORA	25
LOKOMOTIVA	34
BUZËQESHJE MBI BOTË	39
PA TY	44
KATARAKTET	46
POEMË VJESHTË	47
TË HUAJ JEMI	54
EPILOG BREZAVE QË VIJNË	56
DIMRI	58
FUND VJESHTË	59
TI QAVE...	61
TE KËSHTJELLA E HAMLETIT NË DANIMARKË	62
MUNDJA E BALLKANASVE NGA TURQIT	
NË FUSHËN E KOSOVËS MË 1389	65
LAOKOONTI	66

MËSUESET E FSHATIT	73
MALL	75
KRISTAL	76
BJESHKËT E NAMUNA NË DIMËR	78
ARDHJA E VJESHTËS	79
BALSAMOSËSIT E ÇMENDUR	80
MËNGJES DIMRI NË PLAZH	82
RËNIA E DËBORËS	83
FLUTURIMI I PATAVE TË EGRA NË FORMË V-JE	84
MARS	85
AFRIM DIMRI	86
MONOLOG	87
ROMANVRASËSI	89
DRERI	91
PAS DARKE	92
NË STUDION DIMËRORE	94
KOHA E PAMJAFTUESHME	98
AEROPORTI I MESNATËS	100
ORA E LIGË	101
DIMRI NË EVROPËN E BASHKUAR.	
REFUGJATËT SHQIPTARË	102
KRISHTLINDJET NË NEW YORK	103

## MALL

Ca pika shiu ranë mbi qelq.  
Për ty unë befas ndjeva mall.  
Jetojmë të dy në një qytet,  
Dhe rrallë shihemi, sa rrallë.

Edhe m'u duk pak e çuditshme  
Si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes.  
Qiejt e ngrysur pa lejlekë  
Dhe shirat pa ylberë në mes.

Dhe thënia e vjetër e Heraklitit  
Seç m'u kujtua sot për dreq:  
"Të zgjuarit janë bashkë në botë,  
Kurse të fjeturit janë veç".

Në ç'ëndërr kemi rënë kaq keq,  
Që dot s'po zgjohemi ne vallë?...  
Ca pika shiu ranë mbi qelq  
Dhe unë për ty seç ndjeva mall.

ISBN 99943 - 32 - 54 - 6



9 7 8 9 9 9 4 3 3 3 2 5 4 0

Çmimi 500 lekë